



Buletini Mjedisor

GJERMANIA MBËSHKETET PROJEKTET NË FUSHËN E MJEDISIT



Ministri i Mjedisit, Z. Lefter Koka, priti Ministrin e Mjedisit, Energjisë dhe Mbrojtjes Klimatike në Saksoninë e Poshtme në Republikën Federale të Gjermanisë, z. Stefan Wenzel si dhe delegacionin, që e shoqëron gjatë vizitës së tij zyrtare në Tiranë.

Ministri Koka e njohu ministrin Wentzel me arritjet e qeverisë shqiptare në përgjithësi dhe të ministrisë së Mjedisit në veçanti, në harkun kohor të tre viteve, duke theksuar progresin e dukshëm në përafrimin e legjislacionit kombëtar me atë të BE-së dhe hartimin e politikave mjedisore sipas standardeve europiane, rritjen e investimeve me qëllim rehabilitimin e dëmeve të së shkuarës dhe sjelljen e mjedisit në qendër të vëmendjes së opinionit publik. Ai u ndal gjithashtu dhe në arritjet në disa fusha prioritare, që ministria e Mjedisit ka pasur në 2 vitet e fundit.

Më tej, Ministri Koka theksoi se, ndër prioritetet e politikës mjedisore shqiptare janë sfida e ndryshimeve klimatike, mbrojtja e biodiversitetit dhe menaxhimi i integruar i mbetjeve. Duke u ndalur në temën e ndryshimeve klimatike, Ministri Koka tha se Shqipëria ka dorëzuar Kontributin Kombëtar të Synuar para afatit, ndërsa vetëm pak ditë më parë Parlamenti Shqiptar ratifikoi Marrëveshjen e Parisit, duke finalizuar kuadrin ligjor nëpërmjet, të cilit Shqipëria do të përgatitet të marrë një paketë masash, që synon reduktimin me 11.5% të gazeve me

efekt serrë deri në vitin 2030.

Nga ana e tij, ministri Wenzel u shpreh se politika mjedisore është një fushë e re edhe për vendet e Europës. Në vijim ai nënvizoi se, nënshkrimi i Marrëveshjes së Parisit nga qeveria Shqiptare dhe angazhimi që ajo ka marrë, vlerësohet shumë pozitivisht nga qeveria gjermane.

Fushat kryesore me interes të veçantë nga ana e delegacionit gjerman në Shqipëri janë mbrojtja e burimeve natyrore të ujit, cilësia e ajrit, menaxhimi i mbetjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm.

Gjatë takimit u diskutuan rreth çështjeve mjedisore si sfida globale e ndryshimeve klimatike, përfitim të energjisë nga lëndët djegëse të ngurta, shmangjen e trafikut trafikut që ndikon në ndotjen e ajrit si dhe mbrojtjen e natyrës, e veçanërisht kujdesin për zonat e mbrojtura.

Ministri Koka theksoi se ndihma e qeverisë gjermane në fushën e mjedisit ka qënë një ndihmë e vazhduar, përmes projekteve të shumta që janë financuar dhe po vazhdojnë të financohen, kryesisht në fushat e biodiversitetit, ndryshimet klimatike si dhe menaxhimin e integruar të mbetjeve. Duke folur për intensifikimin e

mëtejshëm të bashkëpunimit midis dy vendeve, ministri Koka theksoi se megjithë arritjet e deritanishme Shqipërisë i duhet akoma progres për të përmbyshur standartet e BE-së dhe konventave, ku ajo aderon, ndaj mbështetja e palës gjermane do të ishte e çmuar.

Gjithashtu ministri Koka kërkoi ekspertizën gjermane veçanërisht për menaxhimin e integruar të mbetjeve si edhe në sektorin e ndryshimeve klimatike, në gjenerimin e "vendeve të gjelbërta të punës", asistencë në zbatimin e strategjisë së biodiversitetit, si dhe parja e mundësisë për asistencë teknike në krijimin e rezervateve natyrore të menaxhimit të faunës së egër.

Ministri Wenzel siguroi se do të ofrohet maksimalisht ekspertiza dhe asistencë në fushat e sipërpërmendura.

Palët vlerësuan se Shqipëria dhe Gjermania janë dy vende, që kanë marrëdhënie të shkëlqyera me njëra-tjetrën. Në emër të Qeverisë Shqiptare, ministri Koka falenderoi ministrin Wenzel për ndihmën e çmuar të qeverisë gjermane në fushën e mjedisit nëpërmjet KFW-së dhe GIZ.

Ky takim dypalësh vjen pas vizitës së Ministrisë të Mjedisit z. Lefter Koka në Berlin më 7 maj 2015, ku u prit nga Ministri i Mjedisit të Republikës Federale të Gjermanisë, Znj. Barbara Hendricks.

KONTROLL MBI SUBJEKTET KONCESIONARE NË FUSHËN E PYJEVE

Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve (ISHMP), në zbatim të ligjit të Moratoriumit të Pyjeve, i cili ka hyrë në fuqi në Shkurt 2016, ka kryer inspektimin dhe verifikimin e kontratave ekzistuese për fondin pyjor dhe kullor të subjekteve koncesionare kontraktuese me ministrinë e Mjedisit. Objekt i inspektimit ishte verifikimi në terren i zbatueshmërisë të kontratave nga subjektet, që ushtronin aktivitetin e tyre në prerjen ripërtëritëse të fondit pyjor kombëtar.

Pas kontrollit të ushtruar u konstatua se 10 subjektet, që operonin dhe ushtronin aktivitetin në fushën e pyjeve deri në 11 Shkurt 2016, datë që Moratoriumi i Pyjeve hyri në fuqi, kanë shkelur një sërë kushte të kontratës me të cilat ato operojnë në këtë fushë. Kompanitë e kontraktuara për prerje ripërtëritëse në fondin pyjor kombëtar në raste të caktuara nuk kanë zbatuar detyrimet

që i linden nga këto kontrata.

Në lidhje me abuzimet e shkeljet ligjore të konstatuar gjatë këtyre inspektimeve, ISHMP ka propozuar që ministria e Mjedisit të ndjekë procedurat për heqjen e licensës këtyre subjekteve për ushtrimin e aktivitetit në fushën e pyjeve.

Për disa nga këto subjekte, për shkeljet e konstatuara, u kërkua ndjekja e procedurave për heqjen e licensës së drejtuesve teknikë, të punësuar prej subjekteve, pasi konstatohet shkelje si pasojë e specifikimeve të bërë prej tyre.

Gjithashtu për disa subjekte u kërkua dhe procedim për kallëzim penal në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor, për prerjen e paligjshme të pyjeve ku kompanitë operojnë, pranë qarqeve Elbasan, Korçë, Lezhë, Dibër, Kukës dhe Tiranë.

Fenomeni i shkeljeve ligjore të vërejtura

klasifikohet si prerje e paligjshme e pyjeve me pasoja të rënda dhe përbën kundravajtje penale dhe në referencë të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Kompanitë e kontraktuara për prerje ripërtëritëse në fondin pyjor kombëtar, që nuk kanë bërë mbrojtjen e ngastrave dhe të grup ngastrave nga prerjet abusive, konsiderohen se me mosveprimin e tyre kanë rënë në kundërshtim me pikat kontraktuale.

Gjithashtu Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit dhe Pyjeve dërgoi zyrtarisht në zyrat e 61 bashkive, raportin me dokumentacionin e plotë për masat e propozuara ndaj këtyre subjekteve koncesionare.

Kjo për faktin se tashmë 61 Bashkitë e vendit sipas ligjit në fuqi nr. 48/2016 "Për pyjet dhe shërbimin pyjor" janë pronarë të fondit pyjor kombëtar, ndaj janë autoriteti që menaxhon dhe administron këtë fond të pasurisë kombëtare.

NË KËTË NUMËR:

GJERMANIA MBËSHKETET PROJEKTET NË FUSHËN E MJEDISIT FQ.1

VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDRIIMIT NË MJEDIS 2016- FQ 2

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE- FQ 5

"Misioni i Ministrisë së Mjedisit, është të hartojë dhe propozojë politika, strategji dhe plane veprimi për mbrojtjen dhe administrimin e mjedisit dhe pyjeve në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm, përmirësimi të cilësia së jetës dhe të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian. Përmbyshja e këtij misioni do të realizohet duke marrë pjesë, nxjerr dhe bashkëpunuar veprimtaritë, të cilat çojnë në zhvillime e mirëqenë afatgjata, duke mbrojtur natyrën dhe sensibilizuar opinionin publik".

MIRATOHEM NË PARLAMENT MARRVESHJA E PARISIT

15 Korrik 2016- Në seancën plenare të Kuvendit u miratua projektligji “Për ratifikimin e Marrëveshjes së Parisit në kuadër të Konventës Kuadër të Kombeve të Bashkuara për Ndryshimet Klimatike”

Ratifikimi i Marrëveshjes së Parisit nga ana e vendit tonë është hapi kryesor drejt zbatimit të saj, për të marrë masa mbi efektet e ndryshimeve klimatike si edhe për unifikimin e veprimeve dhe investimeve drejt një të ardhmeje të qëndrueshme, si dhe duke mundësuar reduktimin e gazeve me efekt serrë deri në vitin 2030.

Ratifikimi i Marrëveshjes së Parisit vjen pas një sërë hapash të ndërmarrë nga Ministria e Mjedisit ku mund të përmendim: miratimin e Kontributit Kombëtar të Synuar (INDC) dhe dorëzimin e tij para afateve të kërkuara. Më pas Këshilli i Ministrave miratoi në parim Marrëveshjen e Parisit në Mars 2016 ndërsa Marrëveshja u nënshkrua nga delegacioni shqiptar më 22 prill 2016 në New York.

Ratifikimi i Marrëveshjes së Parisit e lidh vendin tonë

me disa detyrime ndër të cilat zbatimi të detyrueshëm të Kontributit Kombëtar të Pikësnyuar (INDC), pas vitit 2020 në nivel ndërkombëtar dhe rishikimi çdo 5 vjet i INDC-së, me qëllim dhënien e kontributit shqiptar në zbutjen e ndryshimeve klimatike.

Kontributi Kombëtar i Pikësnyuar i hartuar nga ministria e Mjedisit mbulon sektorët që janë të prekshme nga ndryshimet klimatike përmendim këtu fushën e energjisë, bujqësisë, transportit etj.

Ndërkohë ministria e Mjedisit me mbështetjen e donatorëve është duke i paraprirë këtij procesi nëpërmjet hartimit të dokumentave strategjikë dhe kuadrit ligjor për ndryshimet klimatike, ku përmendim Strategjinë për Ndryshimet Klimatike dhe Planin i Veprimit për Reduktim të Gazeve me Efekt Serrë, projektligjin për Ndryshimet Klimatike si dhe një projektvendim të Këshillit të Ministrave “Për ngritjen e një sistemi monitorues, verifikues dhe raportues për shkarkimet e gazeve me efekt serrë.

Ndërkohë Ministria e Mjedisit përfundoi në fund të

muajit qershor Planin Kombëtar për Adaptim ndaj Ndryshimeve Klimatike - NAP, një dokument mjaft i rëndësishëm për të filluar hapat konkretë të zbutjeve të efekteve, që po sjellin ndryshimet klimatike në të gjitha fushat e jetës.

Pakti global i arritur në Paris parashikon strategjinë afatgjatë për mënyrat si shtetet do përballojnë ndryshimet klimatike. Ai synon të pakësojë ndjeshëm rreziqet dhe ndikimet nga ndryshimi i klimës, kufizimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë në atmosferë, si dhe qëllimin final për mbajtjen e ngrohjes globale nën 2 gradë celsius. Angazhimet e vendit tonë për reduktimin e emetimeve të gazeve me efekt serrë janë përfshirë në dokumentin e miratuar të INDC-së sipas të cilit, Shqipëria synon një reduktim prej 11.5% e deri në vitin 2030.

Ky ligji i sapo miratuar “Për ratifikimin e Marrëveshjes është në mbështetje Konventat ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë.

VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS 2016

| Nr | Subjekti | Aktiviteti | Vendndodhja | Eksperti Mjedisor | Vendimi |
|----|-----------------------|--|------------------|-------------------|--------------------------|
| 1 | ABV Konstruksion 2756 | VP Rikonstruksion – Operim - Transferim të HEC Kaparjel, në pellgun ujëmbledhës Përroi i Gugashit | Gjirokastr | Hamdi Hoti | Plotësim Informacioni |
| 2 | Bashkia Korçë | VP Rikonstruksioni i qendrës, infrastrukturës rrugore dhe monumenteve të kulturës të fshatit Voskopoje | Voskopoje, Korçë | Panajot Pilani | Shkresë |
| 3 | Bashkia Mat | VP Kanalizime të ujërave të zeza në fshatin Bushkash | Dibër | Abdullah Diku | Refuzim |
| 4 | STS (fabrike uji) | VP Ndërtim fabrike të imbotilimit të ujit | Gjirokastr | Rexhep Shkurti | Vendim për VNM Paraprake |
| 5 | Vuthaj | VTH Shfrytëzim i mineralit bazalt, në objektin mineralar “Rubik”, zona minerare nr. 392/5” | Mirditë, Lezhë | Lura Studio | Deklaratë Mjedisore |
| 6 | Gener 2 | VTH Shfrytëzim mineral guri gëlqeror me karierë | Vithkuq, Korçë | Studio Projekt | Deklaratë Mjedisore |

| Nr. | Subjekti | Aktiviteti | Vendndodhja | Hartoi Dosjen | Vendimi |
|-----|------------------|---|----------------|---------------|--------------------------|
| 1 | Copri Actor 3321 | VP Vende depozitim dhera/inerte të ndërtimit të rrugës Tiranë-Elbasan | Lundër, Tiranë | E.M.C Studio | Vendim për VNM Paraprake |
| 2 | Copri Actor 3322 | VP Vende depozitim dhera/inerte të ndërtimit të rrugës Tiranë-Elbasan | Lundër, Tiranë | E.M.C Studio | Vendim për VNM Paraprake |
| 3 | Copri Actor 3323 | VP Vende depozitim dhera/inerte të ndërtimit të rrugës Tiranë-Elbasan | Mullet, Tiranë | E.M.C Studio | Vendim per VNM Paraprake |
| 4 | Copri Actor 3324 | VP Vende depozitim dhera/inerte të ndërtimit të rrugës Tiranë-Elbasan | Mullet, Tiranë | E.M.C Studio | Vendim per VNM Paraprake |
| 5 | Copri Actor 3517 | VP Vende depozitim dhera/inerte të ndërtimit të rrugës Tiranë-Elbasan | Mullet, Tiranë | E.M.C Studio | Vendim per VNM Paraprake |

FILLON PUNA PËR NGRITJEN E SISTEMIT TË MENXHIMIT DHE MONITORIMIT TË INFORMACIONIT MJEDISOR

Në 15 Korrik 2016, u zhvillua takimi i Komitetit Drejtues të Projektit “Ngritja e sistemit të menaxhimit dhe monitorimit të informacionit mjedisor në linjë me raportimin global”-EIMs.

Pas 6 muajve nga fillimi i këtij projekti ka përfunduar nga ekspertët kombëtar dhe të huaj raport i mbi situatën legjislativë të Raportimit të të dhënave Mjedisore në Republikën e Shqipërisë si dhe ka filluar puna për realizimin e sistemit të menaxhimit të informacionit mjedisor. Takimi u hap nga Znj. Odeta Çato koordinatore e projektit e cila i njohu të pranishmit me arritjet e deritanishme të projektit dhe më pas i dha fjalën z.Argent Alltari, Drejtor i Kabinetit të Ministrisë në ministrinë e Mjedisit.

Z. Alltari theksoi në fjalën e tij se në gjashtë muajt e parë të zbatimit të tij, projekti i Monitorimit Mjedisor, ka pasur rezultate pozitive. Ai gjithashtu përmendi faktin e zgjerimit të shtirjes së objektivit të këtij projekti dhe në tre konventa të tjera të cilat nuk ishin përmendur në dokumentin e projektit.

Ai përmendi kontributin e ministrisë së Mjedisit, e cila i ka ofruar gjithë asistencën e mundshme ekipit teknik të IT dhe GIS të cilët janë takuar me përfaqësues të të gjithë sektorëve të Ministrisë, të cilët kanë dhënë mbështetjen me informacionet e nevojshme për realizimin e sistemit, për të mundësuar një monitorim sipas standarteve të kërkuara të Bashkimit Europian. Ai gjithashtu theksoi faktin që duhet përdorur e shfrytëzuar se ma shumë çdo informacion apo “know how” nga gjithë partneret e angazhuar në fushën e monitorimit mjedisor dhe ngritjes së kapaciteteve. Një bashkëpunim nga projekti i është kërkuar dhe organizatave joshpetërore që veprojnë në fushën e monitorimit të Mjedisit si; GIZ, REC, Shoqata e Bregdetit Francez CdL, INCA, bashkëpunimi me këto do të mundësoj për të arritur një sinergji të vazhdueshme.

Nga bashkëpunimi deri tani është vërejtur se REC ka një eksperiencë në fushën e forcimit të kapaciteteve në sektorin e Mjedisit, e mundësuar nëpërmjet

programit “Mbështetje për organizatat mjedisore të shoqërisë civile në Shqipëri” falë kjo dhe eksperiencës së punës në vite të këtij organizmi ndërkombëtar.

Në vazhdim, znj Çato bëri një prezantim të gjetjeve më të rëndësishme të raportit të ekspertit ndërkombëtar në lidhje me VKM mbi monitorimin mjedisor. Duke përmendur rëndësinë e përshtatjes me kërkesat e Agjencisë Evropiane të Mjedisit si edhe me futjen e indikatorëve të rëndësishëm të monitorimit mjedisor. Një nga propozimet e bëra nga ekspertët duke parë dhe eksperiencat europiane u përmend dhe se Shqipëria duke qënë një vend i vogël gjeokrafikisht mund të shihet mundësia që Raportet e Gjendjes së Mjedisit të hartoheshin çdo 3 vjet, sepse indikatorët e matshëm në lidhje me gjendjen e mjedisit nuk kanë ndryshime kaq të mëdha në një periudhë 1 vjeçare, siç kërkohet raportimi mbi gjendjen e mjedisit nga legjislacioni aktual mjedisor.

Një nga pikat e diskutueshme gjatë këtij takimi ishte dhe përllogaritja e kostos së monitorimit të të dhënave për mjedisin një kosto mjaft e lartë për të gjithë indikatorët e kërkuar. Nga përfaqësuesi i Ministrisë së Energjisë, u ngrit shqetësimi mbi gjetjen e mundësive të financimit. z. Alltari shpjegoi se ministria e Mjedisit duke parë këto objektiva si edhe përputhshmërinë e tyre me prioritetet e saj përpjet të parashikoj sa më shumë fonde brenda buxhetit të shtetit, që mundësojnë realizimin e disa prej këtyre aktiviteteve të parashikuara për monitorimin e Mjedisit. Ai përmendi edhe faktin që të gjithë jenë të ndërgjegjshëm në lidhje me kufizimet financiare me të cilat përballemi, por përmendi angazhimin e përhershëm të Ministrisë për të siguruar sa më shumë fonde edhe nëpërmjet donatorëve të ndryshëm.

Fjalën e mori z.Renato Kurti, konsulent IT, i cili bëri një prezantim të shkurtër rrugës që do të ndiqej (ROADMAP- it) për arritjen e objektivave të këtij aktiviteti të parashikuar nga ky projekt. Të pranishmit u informuan se UNDP do të mbështesë

përfshirjen e informacioneve të mbledhura në një “database” qëndror, me qëllim informimin dhe raportimin sipas detyrimeve që shteti shqiptar ka aktualisht kundrejt Konventave që ka nënshkruar. Z.Kurti dhe Z.Biti, konsulenti GIS, falënderuan ministrinë e Mjedisit për ndihmesën e saj në mundësimin e takimeve me gjithë aktorët e procesit të monitorimit mjedisor. Ata gjithashtu theksuan se sistemi, i cili do të ngrihet, do të mbledhi informacionin nga gjithë institucionet e linjës, mbetet për t'u diskutuar procesi i mbledhjes dhe frekuenca e të dhënave etj. Konsulentët theksuan rëndësinë e takimeve të shpeshta të grupit teknik për t'u informuar për çdo gjë të re që mund të ndihmojnë në punën e tyre. Ata përmendën shqetësimin se asnjë prej sistemeve egzistuese nuk bën shkëmbim të informacionit dhe kjo do të duhet të zgjidhet. Aktualisht të gjitha sistemet janë ose do të ndërtohen “open source”, për publikun ashtu siç kërkohet dhe nga Konventa e Aarhusit, ku Shqipëria është palë.

Z. Alltari theksoi se Sistemi i Monitorimit Mjedisor duhet të jetë sa më i integruar dhe të përfshijë sa më shumë të dhëna që të jetë e mundur. Ai gjithashtu përmendi se duhet të njihim problematikat ekzistuese të raportimit, se çfarë informacioni mjedisor mundësohet nga institucionet tona dhe se çfarë projektesh analoge ka, prej të cilëve ne mund të shfrytëzojmë pjesën më të mirë.

Në përfundim të takimit u përcaktuan hapat e mëtejshëm për realizimin e këtij projekti që ishin

Vazhdimi i bashkëpunimit me gjithë të gjithë aktorët e monitorimit mjedisor dhe njohja me të gjitha projektet aktuale të institucioneve të linjës;

Materializimi i bashkëpunimi me REC përmes një marreveshje në lidhje me vlerësimin dhe ngritjen e kapaciteteve për shoqërinë civile dhe institucionet e tjera në vazhdim të punës që REC është duke realizuar me fonde të BE.

Gjithashtu do të vijojë bashkëpunimi me grupet teknike përkatëse për ngritjen e sistemit të informacionit.

VENDIMET E KOMISIONIT PËR VLERËSIMIN E NDIKIMIT NË MJEDIS 2016

| Nr. | Subjekti | Aktiviteti | Vendndodhja | Hartoi Dosjen | Vendimi |
|-----|---------------|---|-----------------|------------------|--------------------------|
| 1 | Bashkia Fier | VP Rikonstruksion i rrugës dhe rehabilitim i fasadave të rrugës ‘Mujo Ulqinaku’ | Fier | ALEKSANDER RUKAJ | Vendim për VNM Paraprake |
| 2 | Birra Smile | VP “Prodhim birre” | Bushat, Shkodër | Arjeta Dibra | Refuzim |
| 3 | Haxhi Gurguri | VP “Kompleks shërbimesh 2 kat bar-kafe, karburant, pikë furnizimi me gaz të lëngshëm” | Fier | Aleksandër Rukaj | Plotësim Informacioni |
| 4 | Kevger | VP “Shfrytëzim mineral kromi në objektin ‘Gal. 44,43 Zona D’ | Bulqizë, Dibër | Remzi Pupli | Plotësim Informacioni |
| 5 | Sam One | VP “Ndërtim godinë për fabrikë të prodhimit të veshjeve 2 kate | Mëzes, Tiranë | " ECA " Studio | Vendim për VNM Paraprake |



“Planet për të mbrojtur ajrin, ujin, florën dhe faunën, janë në fakt plane për të mbrojtur njeriun”

Stewart Udall

SEKTORI I TRANSPRENCËS DHE KOMUNIKIMIT

NGA AKTIVITETET E ORGANIZATAVE MJEDISORE

TË FORCOJMË SHOQËRINË CIVILE PËR REAGUAR KUR NUK DËGJOHET PËR VENDIME MJEDISORE



Milieukontakt Shqipëri, EcoAlbania dhe LexFerenda organizuan në qershor 2016 takimin prezantues të projektit “HELP – CSO, Forcimi i Legjislacionit Horizontal dhe Promovimi i Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC)”.

Në fjalën e tij Z. Rezart Kapedani, menaxher i granteve të programit Achieve, theksoi se një nga rezultatet e pritshme të këtij projekti do të jetë organizimi i forumeve të OSHC-ve dhe dalja me rekomandime në lidhje me zbatimin e legjislacionit horizontal, për të cilat do të lobohet që të përfshihen në kapitullin 27 të Raportit t BE për Shqipërinë.

Informimi dhe pjesëmarrja e publikut në Shqipëri rezultoi të jetë një proces problematik dhe për pasojë reagimi i organizatave të Shoqërisë Civile dhe i individëve ka qenë i dobët. Kjo vihet re sidomos në zhvillimin e projekteve të HEC-eve, ku për shkak të mungesës së njohurive ligjore mjedisore procesi i pjesëmarrjes së publikut shpesh herë ka krijuar konflikte në komunitetet e prekura. Organizatat mjedisore kombëtare dhe ndërkombëtare kohët e fundit janë organizuar duke realizuar aktivitete të përbashkëta për të mbështetur komunitetet e prekura nga ndërtimi i HEC-eve dhe kanë lobuar për të rritur vëmendjen e vendim-marrësve kundrejt respektimit të standardeve mjedisore gjatë këtij procesi.

Megjithatë mungesa e njohurive mbi legjislacionin horizontal dhe zbatimin e tij në projektet mjedisore ka sjellë nevojën për realizimin e disa aktiviteteve trajnuese dhe mbështetëse për organizatat lokale dhe komunitare në lidhje me pjesëmarrjen publike në projektet e përdorimit të ujit, monitorimin e zbatimit të legjislacionit horizontal si dhe mbështetjen ligjore falas për raste specifike. Ekspertët ligjor, pjesë e ekipit të punës së HELP-CSO do të japin asistencë ligjore duke ndihmuar në aftësimin e organizatave mjedisore për t’u drejtuar organeve të gjyqësorit apo rekomanduar përmirësime ligjore e politikash.

Për të vazhduar dhe konsoliduar punën e nisur nga grupimi “Të mbrojmë lumenjtë”, pjesë e të cilit janë dhe vetë organizatorët, me anë të këtij takimi ata synonin krijimin e një Fokus Grupi të organizatave të shoqërisë civile, që do të punojnë së bashku për

vlerësimin e përafrimit të legjislacionit horizontal mjedisor sipas Direktivave të BE. Komponent i rëndësishëm i këtij takimi ishte dhe krijimi i një platforme dhe strategjie komunikimi në shërbim të punës së përbashkët të këtij Grupi Fokus përgjatë projektit e më tej.

Rreth 10 organizata lokale dhe kombëtare i’u bashkuan grupimit për të dhënë mbështetje e kontribut në vazhdimësinë e punës së përbashkët dhe u bënë pjesë e diskutimeve në grupe mbi tre tematikat kryesore: hartimi i Memorandumit të Bashkëpunimit; vizibiliteti dhe faja tematike e internetit, si dhe nxitja e iniciativave lokale.

Ky projekt mbështetet financiarisht nga Bashkimi Evropian nëpërmjet programit ACHIEVE i zbatuar nga Qendra Rajonale e Mjedisit - REC Shqipëri.

TË MBROJMË ZONËN E ULZËS



Organizata “Miqësia” Ulzës, në bashkëpunim me Organizatën mjedisore Kthellë, Milot, Ulzës, dhe shoqatat e peshkatarëve të liqenit, organizuan një takim mbi evidentimin e problemeve të peshkimit dhe cilësinë e ujërave në liqenin ULEZ. Ky takim u mundësua nga Qendra Rajonale e Mjedisit në Shqipëri (REC), në kuadër të programit SENiOR_A, për organizatat e shoqërisë civile në mbrojtje të Mjedisit, financim i Qeverisë Suedeze (SWEDEN) dhe nga Instituti i Mbrojtjes së Natyrës (INCA).

Në takim mermin pjesë si të ftuar, biolog të Universitetit Bujqësor Tiranë, sekretari i përgjithshëm i FOUBN Shkodër, inspektorët e peshkimit në bashkinë e Lezhës, përfaqësues të INCA, përfaqësues të REC Shqipëri, përfaqësues të OJQ “PSEDA ILIRIA”, Ekolëvizjes, si dhe aktorë të tjerë lokalë. Diskutimet dhe debatet mes të pranishmeve ishin shumë efektive në funksion të mbrojtjes së florës, faunës dhe mjedisit, aq më tepër kur zona e Ulzës është shpallur Park Natyror Rajonal dhe ka tashmë një plan menaxhimi.

NJË SHËMBULL PËR T’U NDJEKUR

EKO Mendje, Well Point dhe Eco Volis me mbështetje të REC ndërmorën një nismë të quajtur “JEP dhe MERR FRYME PYLLIT”, pastrimin sensibilizues në pyllin e Velipojës.



Nga qëndra e Velipojës e deri në pyllin e Vilunit u pastrua krejtësisht pylli (aty ku nuk ishte r rrethuar me tel) nga mbetjet organike, toksike dhe plastike. Të rinjtë vullnetar mblodhën gjithsej 124 qese me mbeturina, duke krijuar mundësitë që pylli mund të marrte frymë si dhe duke siguruar më shumë oksigjen për banorët e zonës .

Pas pastrimit, nuk mungoi dhe festa pranë bregut të detit dhe në qëndër të Velipojes me muzike dhe me lojra.

Eko Mendje ka filluar të aplikojë këtë formë të ndërgjegjësimit në disa nga pikat turistike të vendit. Kështu në javën e fundit të Korrikut u organizua një udhëtim me biçikleta në Parkun e Pezës dhe Liqenin e Fjollës. Të rinjtë pasi pastruan parkun nga mbeturinat shijuan pjesën tjetër të mbetur të ditës në natyrë.



EKOLËVIZJA OFRON TRAJNIM PËR SHOQATAT MJEDISORE



Në 12 Korrik 2016, Shoqata Ekolëvizja zhvilloi takimin informues mbi nisjen e zbatimit të një programi të ri në mbështetje të shoqërisë civile, përgjatë tri viteve të ardhshme (2016-2018) me titull: Mbështetje për Organizatat Mjedisore të Shoqërisë Civile në Shqipëri (SENiOR-II) zhvilluar nga Qendra Rajonale e Mjedisit (REC) Shqipëri, me mbështetjen e Agjencisë Suedeze për Kooperim dhe Bashkëpunim (SIDA).

Ky program vjen si vazhdim i një programi të ngjashëm (SENiOR-A) të zbatuar nga REC Shqipëri gjatë periudhës 2012-2015.

Në takim morën pjesë aktorët e shoqërisë civile, për identifikimin e bashkëpunësorëve potencialë në zbatimin e programit dhe vlerësimin e objektivave specifike të tij, në përputhje me nevojat konkrete të shoqërisë civile për një zhvillim më cilësor të sektorit. Takimi shërbeu dhe për pasjen e një qasje më të plotë e gjithëpërfshirëse në hartimin e dokumentit, mbi të cilin do zbatohet ky program.